

ndaj tyre. Në mesin e anëtarëve të familjes shpërtheu paniku dhe të gjithë tentuan të iknin me vrap, duke kërkuar ndonjë strehim nga të shtënat. E para u plagos nëna e Shefqetit. Më pas, një plumb e qëlloi Shefqetin në zemër. Anëtarë të tjerë të familjes Hoxha qëndruan së shprehuri deri në mëngjes dhe, më pas, u larguan nga vendi i ngjarjes. Po atë ditë, pas lejes paraprake të policisë serbe, vëllezërit e Shefqetit, Valdeti dhe Nysreti, e kanë varrosur Shefqetin në varrezat e Suharekës/Suva Reka.

**Burimet:** deklarata V.S, FDH-32550; deklarata A.H, FDH-10112; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.D.00697, FDH-35626; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; *At least 2 Killed and 5 Wounded in Suhareka Area in the Past 24 Hours*, newsletter, KIC, 24.08.1998, FDH- 29504.

## Sahit (Isuf) Jahaj

(1936, shqiptar nga Sllapuzhani/Slapuzane, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, pesë fëmijë)

Sahiti me gra dhe fëmijë e braktisën Sllapuzhanin/Slapuzane më 17.08.1998, ndërkaq që të tre djemtë e tij ndenjën në shtëpi. Ai u kthye në fshat më 22.08.1998, për t'i vizituar të bijtë. Ditën e nesërme, më **23.08.1998**, kur forcat serbe e nisën bombardimin e **Sllapuzhanit/Slapuzane**, djemtë e Sahitit ikën në pyll, ndërkaq Sahiti u nis drejt qendrës së fshatit, ku gjendeshin ushtarë të UÇK-së. Dhjetë ditë më vonë, trupin e pajetë të Sahitit e kanë gjetur ushtarë të UÇK-së në afërsi të stacionit-trafo. E kishin qëlluar me granatë. E varrosën në afërsi të vendit të vrasjes. Në muajin nëntor të vitit 1998, në prani të vëzhguesve të OSBE-së, policia i ka transferuar mbetjet mortore të Sahitit në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata N.L, FDH-10677; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.D00697, FDH-35626; fotografi, FDH-20985.

## Ymer (Latif) Jahaj

(1950, shqiptar nga Sllapuzhani/Slapuzane, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, pesë fëmijë)

Në datën **23.08.1998**, kur forcat serbe e sulmuan fshatin, Ymeri me familje kaluan

në fshatin fqinj të Preshanit/Prešane. Në mbremje, Ymeri me komshiun Halit Elshanin u kthyen në **Sllapuzhan/Slapuzane**. Kishte rënë terri i natës kur kanë hyrë në oborrin e Halitit. Atje i panë ushtarët serbë dhe ikën me vrap nga oborri. Ushtarët shtënën ndaj tyre. Ymerin e qëlluan për vdekje, ndërkaq Haliti arriti që të ikte nga vendi i ngjarjes. Pesë ditë më vonë, djemtë e Ymerit, Sedati dhe Nexhati, u kthyen në shtëpi dhe e varrosën të atin në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata N.J, FDH-10668; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.D00697, FDH-35626; fotografi, FDH-20985.

## Mehmet (Daut) Lumi

(7.08.1970, shqiptar nga Bllaca/Blace, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

## Safet (Ilaz) Kicaj

(9.08.1977, shqiptar nga Grejkoci/Grejkovce, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Prindërit e Safetit kanë pësuar në një aksident trafiku dhe ai me të vëllain jetonin te familjet e axhëve në Grejkoc/Grejkovce. Në UÇK ka aderuar në fillim të muajit korrik të vitit 1998. Në datën **23.08.1998**, Mehmeti dhe Safeti ndodheshin në pozicionet e ushtrisë në **Grejqefc/Grejçevce**. Që të dy e kanë humbur jetën nga eksplodimi i granatës, në çastin kur u nisën që të strehoheshin në një bunker të improvizuar. Safetin e kanë varrosur më 24.08.1998 në Grejkoc/Grejkovce, ndërkaq Muhametin në Guncat [Malishevë/Mališevo] një ditë më vonë. Pas përfundimit të luftës, më 18.09.1999, mbetjet mortore të Safetit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Suharekë/Suva Reka. Mbetjet mortore të Mehmetit u rivarrosën më 21.10.1999 në varrezat e Grejqefcit/Grejçevce.

**Burimet:** deklarata M.K, FDH-32532; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; fotografi, FDH-20988; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; fotografi, FDH-19086; *Serb Offensive against Suhareka Villages Escalates* newsletter, KIC, 25.08.1998, FDH- 29505; *Suhareka Villages Still under Serb Fire Today*, newsletter,